



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Nr. 25

Datë: 28. 05. 2020. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.16,17 dhe 18/2020;

**2. Aktivitete e ZRPPC-së:**

- Shqyrtimi i Raportit për azhurnimet e të dhënave vjetore të PP-ve.
- Shqyrtimi i Raportit për dorëzimin e Raporteve të shpenzimeve vjetore të partive politike.
- Shqyrtimi i Raportit për deklarimin e partive politike për vazhdimin e regjistrimit.
- Shqyrtim i kërkesës së partisë politike Lëvizja për Bashkim (LB) për shtyrje të afatit për mbajtje të Kuvendit Zgjedhor.

**3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

- Këshilli për Çështje Ligjore:

- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal në Klinë.

#### 4. **Themelimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm.**

#### 5. **Të ndryshme.**

#### 6. **Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** Mirë se erdhët në mbledhjen e 25-të, rendin e ditës e keni pasur me kohë. A kemi ndonjë vërejtje, propozim...?

**Sami Kurteshi:** Pajtohem me rendin e ditës, por mendoj se tash ka ardhur koha për të diskutuar për zgjedhjet në Podujevë, lidhur me procedurat, kriteret dhe me caktuar një datë për mbajtjen e tyre...

**Arianit Elshani:** Në kuadër të këshillit për çështje operacionale, është shqyrtuar kjo pikë dhe e kemi diskutuar, dhe e kemi një informatë që kryeshefi mund të na informojë...

**Alim Rama:** Po, ama ne e kemi lënë që ta diskutojmë më mirë në KQZ, sepse këshilli nuk ka marrë ndonjë vendim...

**Valdete Daka:** Ne si KQZ, as nuk caktojmë datë as nuk marrim vendim dhe se, dihet se kompetencë e kujt janë. Ne, nuk mund të kemi kërkesë as kompetencë, kjo është kompetencë ekskluzive e Presidentit...Por, nëse ju propozoni me qitë në rend dite, s'ka problem...

**Sami Kurteshi:** Ne jemi trupë politike, dhe ne çdo gjë që e diskutojmë është politike dhe nuk ka politizim...Ne jemi demokraci e re, dhe se kjo te ne ngjan për herë të parë me u shty zgjedhjet, sepse ka qenë çështje pandemie. Pra, sa i përket shtyrjes, rekomandimit etj., ne kemi marrë një vendim të drejtë, por ne sipas ligjit dhe të gjitha normave, kemi bërë një lëshim: i kemi shtyrë zgjedhjet pa e caktuar një datë se, kur do të mbahen ato. E kjo, është e ndaluar ! Kjo, mendoj që nuk ka qenë në rregull, nuk ka qenë e lejuar për afat të pacaktuar!

Tash, është një moment: çdo zyre tjetër i merr vendimet në bazë të rekomandimeve të institucioneve kompetente...Në këtë rast, ne jemi një institucione kompetent,

kurse caktimi i datës vjen nga Zyra e Presidentit. Shumë në rregull, prandaj unë po kërkoj të diskutojmë se kur duhet me u mbajt, për ku, cilat duhet të jenë arsyet pse s' duhet me u mbajt...? Sipas të gjitha ligjeve zgjedhore, ne duhet ta kemi një afat...

**Alim Rama:** Pse është i rëndësishëm një afat..? Presidenti i ka shty zgjedhjet në bazë të rekomandimit të KQZ, kurse KQZ e ka marrë vendimin në bazë të ISHPK-së, kështu që mbasi ka qenë ky shtegu që janë shtyrë zgjedhjet, mendoj që KQZ duhet me ia bërë një kërkesë ISHPK-së që ta vlerësojnë situatën...

**Valdete Daka:** Si informacion: ne nuk i kemi shtyrë zgjedhjet, por ato janë shtyrë nga presidenti, dhe ne nuk mundemi me caktuar datën...Nuk mund ta caktojmë, as atëherë se kemi caktuar! Edhe në regjion, janë shtyrë zgjedhjet për shkak të pandemisë... Mos harroni që zgjedhjet mbahen për subjektet politike, dhe me siguri edhe ato kanë kandidatët në Podujevë, dhe ato do të kenë interesin e tyre që të mbahen këto zgjedhje...

**Čemailj Kurtiši:** Faleminderit. Ne, gjithmonë duhet të jemi të gatshëm për t'i mbajtur zgjedhjet, por dihet kush bjen vendim për mbajtjen e tyre. Unë mendoj se pas 1 qershorit, do të kemi më shumë informacione. Nuk kemi çka të bisedojmë, kjo çështje nuk është në dorën tonë...

**Valdete Daka:** unë mund ta hedh në votim këtë propozim të Samiut dhe Alimit...

**Sami Hamiti:** Datë me caktua...? Jemi jashtë saj, por ne duhet të jemi të gatshëm t'i mbajmë, pra ku jemi...por, është qesharake të diskutojmë për atë që nuk jemi kompetent...! Ne, s'mund të japim interpretime kur e qysh, sepse kjo nuk është në kompetencën tonë...

**Sami Kurteshi:** Ne, e bëmë diskutimin, tani qysh të doni...! Me rëndësi është që diskutuam, tash a e fusim apo jo në rend dite, kjo...

**Alim Rama:** Na s'kemi lyp datë, ne kemi kërkuar me diskutua dhe a jemi të gatshëm për zgjedhje. Edhe njëherë po e rikujtoj: kërkesa e parë ka ardhur nga ISHPK-ja, me i vlerësua rrethanat...Edhe tash: zgjedhjet janë të shpallura, dhe duhet me diskutua se cilët janë hapat që ne duhet me i ndërmarrë...

**Valdete Daka:** KQZ është institucion që i organizon zgjedhjet dhe që kujdeset për mbajtjen e tyre, dhe i certifikon rezultatet...Se kur duhet të mbahen, KQZ –ja as nuk mundet me diskutua, as nuk e cakton datën... Kurse, a duhet ti mbajmë dhe ti organizojmë zgjedhjet...? Ne, për këtë ekzistojmë...Mendimin e ISHPK-së, ne e kemi kërkuar se a ka kushte për shkak të pandemisë, sepse e kishim të caktuar datën e zgjedhjeve...Edhe sot, pandemia ende ekziston...! Ne, jemi palë organizuese, kurse subjektet politike janë ato që diskutojnë se a me mbajt, apo jo zgjedhje...

**Sami Kurteshi:** Për mua, diskutimi u zhvillua dhe, unë nuk bëra ndonjë kërkesë vetëm propozova që të diskutojmë...

**Valdete Daka:** Mendoj që diskutimet u kryen, dhe e qesë në rend votim rendin e ditës...Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimitisht rendin e ditës.

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ-së, shqyrtuan procesverbalet e mbledhjeve nr.16, 17 dhe 18/2020. Gjatë shqyrtimit, anëtari i KQZ-së, kërkoi që përgjatë votimit “për, kundër apo abstenim” të shënohen emrat... Të njëjtën kërkesë, pati edhe z. Cemajl Kurteshi dhe Arianit Elshani. Mbas kësaj kërkesë, anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimitisht këto procesverbale.

## **2. Aktivitete e ZRPPC-së:**

### **1.Shqyrtimi i raportit për azhurnimet e të dhënave vjetore të PP-ve:**

**Yll Buleshkaj:** Kemi disa pika nga zyra. Mbi bazën e rregullave dhe ligjeve në fuqi, partitë politike paraqesin raportet e zhurnimeve të të dhënave vjetore. Deri më më 31 janar, 2019, nga 48 parti politike të regjistruar në Regjistrin e Partive Politike të ZRPPC-së, 44 janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa katra, jo. Dy nga këto parti, nuk kanë qenë të obliguara sepse, njëra është regjistruar në mesin e janarit, kështu që nuk ka pasur nevojë, kurse tjetra, ka dorëzuar një kërkesë për c’regjistrim, dhe kjo është Partia Euroatlantike e Kosovës. Kërkesa, është në shqyrtim e sipër sipas rregullave. Sipas rregullave dhe ligjeve, për shkak të mos përgjigjes së tyre, kemi rekomanduar që dy parti politike të pezullohen. Këto janë: Samostalna Liberalna Stranka dhe Lëvizja për Drejtësi.

**Sami Kurteshi**: Kam pyetje: a është kërkesa vetëm për pezullim, apo..?

**Valdete Daka**: Jo, njëherë vetëm pezullimi, pastaj vjen c' regjistrimi...

**Sami Kurteshi**: Tjetra: partitë politike janë persona juridik. A janë këto kërkesa vendimarrëse, për shembull nga Kuvendi, apo nga individët, për shembull kryetari i partisë...?

**Yll Buleshkaj**: Rekomandimi është yni, sepse këto dy parti nuk kanë dorëzuar raportin, ashtu siç janë të obliguara me ligj. Zyrtarët financiarë të këtyre subjekteve, nuk i janë përgjigjur zyrës... Kurse te subjekti që ka kërkuar c' regjistrimin, kërkesën e ka sjellur kryetari i kësaj kërkesë... Për të gjitha çështjet, ekzistojnë rregullat në fuqi se si vihet deri te një kërkesë, rekomandim...

**Eshref Vishi**: ...Ka të bëjë me çështje procedural të ZRPP-së! Unë mendoj që ZRPPC, me këtë rast, disa çështje që i ka ngritë, e ka anashkuar rregulloren e punës së KQZ-së sepse, ZRPP në rastet kur ka rekomandime duhet t'i adresohet Këshillit për Çështje Ligjore. Nuk kemi adresime në këshill, prandaj duhet ta ndjekim praktikën e deritashme...

**Valdete Daka**: Sa di unë, ZRRP na i dërgon direkt rekomandimet e tyre pa kaluar nëpër këshilla, pra nuk kemi pas kësaj praktike...

**Eshref Vishi**: Unë e kam lexuar rregulloren...!

**Arianit Elshani**: Po është fakt, neni 25, pika c, e specifikon këtë...! Mendoj se, është dashur me kalua në këshill, dhe me ardhur në KQZ.

**Valdete Daka**: Deri më tash, nuk e kemi pas praktikë, edhe pse ZRPP ka të drejtë t'i dërgoj direkt në KQZ...

Atëherë, kush është për pezullimin e këtyre dy subjekteve ? Konstatohet se me 10 vota për, pezullohet partia SLS dhe Lëvizja për Drejtësi.

## **2. Shqyrtimi i raportit për dorëzimin e Raporteve të shpenzimeve vjetore të partive politike:**

**Yll Buleshkaj:** Partitë, janë të dërguar për dorëzimin e raportit financiar, deri më 1 mars. Të gjitha i kanë dorëzuar, përveç partisë Evropaska Stranka Demokracije, duke përjashtuar dy partitë që i përmendëm më lartë... Nga kontakti me këtë parti, ata na kanë thanë se nuk mund ta dorëzojnë raportin sepse, zyrtari nuk ndodhet në Kosovë për shkak të padnemisë, por afati ligjor ka kaluar. Më 1 mars, nuk kemi pasur pandemi. Ne, sipas ligjit rekomandojmë për dënimin me gjobë prej 1000 euro, si dhe gjoba shtesë: 0.01% për çdo ditë vonesë...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me 10 vota për, këtë rekomandim për gjobitje të partisë: DES

**Sami Kurteshi:** Raportet e shpenzimeve vjetore... auditimin e bënë vetëm KQZ-ja apo i jepet ndonjë auditori. Në bazë të sanksioneve apo shkeljeve, sa është KQZ-ja konsekuente në zbatimin e sanksioneve...?

**Yll Buleshkaj:** KQZ, nuk auditon, vetëm i mbledh raportet... Kuvendi merret me këtë punë... Kur e kërkon Kuvendi, ne ua dërgojmë raportet... Por, ende nuk janë bërë auditime që dy vite...

## **3. Shqyrtimi i raportit për deklarimin e partive politike për vazhdimin e regjistrimit:**

**Yll Buleshkaj:** Partitë, janë të obliguara të sjellin një formularë se, a dëshirojnë të qëndrojnë në Regjistrin e Partive të ZRPP-së. Afati, ka qenë deri më 31 mars... Nga 48, vetëm 37 e kanë dërguar formularin. Si ZRPP, kemi kërkuar që të shtyhet ky afat nga KQZ, deri në fund të muajit maj për shkak të situatës... Kemi edhe dy ditë afat...

**Sami Hamiti:** Ua shtyjmë afatin deri më 5 maj...!

**Nenad Rikallo:** Situata specifike është për shkak të pandemisë, por si Zyre, ju mund ti caktoni afatet... edhe sipas nenit 21... Ndërkaq, me këtë rast afati është shyrë

60 ditë, dhe nuk mendoj se duhet të marrim ndonjë vendim tjetër...s'ka pse të shtyhet më shumë afati...

Në këtë pikë, diskutuan më tej edhe: Eshref Vishi, Valdete Daka, Yll Buleshkaj (ZRPP), Arianit Elshani, Sami Hamiti dhe Nenad Rikallo.

Anëtarët e KQZ-së, me 6 vota për, 3 abstenime dhe 1 votë kundër miratuan këtë rekomandim.

#### **4. Shqyrtim i kërkesës së partisë politike Lëvizja për Bashkim (LB) për shtyrje të afatit për mbajtje të Kuvendit Zgjedhor:**

**Yll Buleshkaj:** E kemi këtë kërkesë nga Lëvizja për Bashkim e cila, është dashur ta mbajë kuvendin e saj më së largu deri më 14 maj, mirëpo për shkak të gjendjes nuk ka mundur...Prandaj, ata kanë kërkuar që kjo të shtyhet deri më 14 nëntor. Janë edhe disa parti që kanë kërkuar shtyrje të mbajtjes së kuvendeve, dhe ne do ti sjellim rekomandimet...!

Anëtarët e KQZ-së, vendosën me vota unanime për këtë rekomandim që, kuvendi i LB-së të mbahet deri në afat, 14 nëntor, 2020.

#### **7. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

##### **Këshilli për Çështje Ligjore:**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal në Klinë.

**Arianit Elshani:** Këshilli, në mbledhjen e mbajtur sot, ka shqyrtuar një kërkesë për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal në Klinë, dhe rekomandon tutje në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit.

**Valdete Daka:** Kush është për që znj. Shkurie Shala nga subjekti politik PDK, të emërohet anëtare e kuvendit komunal të Klinës, duke e zëvendësuar anëtares të deritashme znj. Shqipnora Dauti.

Anëtarët e KQZ-së, vendosën me vota unanime për këtë rekomandim.

## **8. Themelimi i Komitetit të Auditimit të Brendshëm.**

**Valdete Daka:** Siç e dini, ne kemi mbetur mbrapa me themelimin e komitetit të auditimit, si një obligim edhe ligjor... Ka ardhur momenti i fundit, kur duhet ta themelojmë dhe, sipas ligjit Komiteti duhet t'i ketë 5 anëtar ( 2 të brendshëm, dhe 3 të jashtëm), ose me 3 anëtarë që është pak e vështirë...Por, neve na mbetet që së pari, me sa anëtarë, do ta themelojmë...!

**Alim Rama:** Unë, mendoj të jenë 5 anëtarë sepse, rekrutimi i anëtarëve bëhet në afate të shkurtëra ! Për ta rritur transparencën dhe llogaridhënien, propozoj që komiteti t'i ketë 5 anëtarë.

**Valdete Daka:** Ne kemi provuar të kemi një komitet me 5 anëtarë, por s'ia kemi arritur...

**Eshref Vishi:** Pajtohem me kryetaren që, ka probleme me e konstituuar komitetin...

**Valdete Daka:** Udhëzimi administrativ (i vitit 2019), anëtarët duhet të kenë përvojë 2 vjeçare

Së paku në njërin nga këto fusha: financa, kontabilitet, auditim të brendshëm, auditim të jashtëm, menaxhim të rrezikut, legjislacion dhe teknologji informative.

**Sylejman Gashi** (auditor i brendshëm ): Ky është organ këshillëdhënës i KQZ. Ajo që është e rëndësishme, komiteti duhet të jetë kompetent. Udhëzimi e thotë ndryshe, por është mirë që anëtarët e komitetit të jenë nga fusha e auditimit. Por, nuk ka mundësi me u mbulua nga auditorët e jashtëm, sepse një auditor nuk ka të drejtë me qenë anëtarë, më shumë se në një komitet tjetër...

Në këtë pikë, debatuan – kryesisht në gjetjen e mundësive se mbi c'bazë ligjore, të themelohet komiteti: Sami Kurteshi, Valdete Daka, Sylejman Gashi (auditor i brendshëm).

**Valdete Daka:** Unë kam propozim konkret: që ne ta marrim vendimin për themelim...! Ne, ta bëjmë publike çështjen, e gjejmë formën...

Atëherë, ne po marrim vendim që komiteti të themelohet me 5 anëtarë: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, vendosën me vota unanime që të themelohet Komiteti i Auditimit me 5 anëtarë.

**Valdete Daka**: Unë, propozoj që si anëtarë të jetë Sami Hamiti, meqë vjen nga fusha e shkencave ekonomike, por edhe Eshref Vishi.

**Sami Kurteshi**: Propozoj që Eshrefi të jetë kryetar i këtij komiteti, a pajtoheni...?

**Arianit Elshani**: Edhe unë e shprehi dëshirën me qenë anëtar i këtij komiteti, por tash si e thotë ligji që, 2 anëtar me qenë nga brenda institucionit dhe jo më shumë. Ndonëse, është praktikë që si opozitë, ma marrë pjesë...

**Valdete Daka**: Atëherë, kush është që Eshref Vishi me qenë kryetar i këtij Komiteti... Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë propozim.

**Arianit Elshani**: Unë kisha pasur dëshirë me qenë anëtarë...

**Sami Hamiti**: Unë heqë dorë...s'ashtë problem, pra kush ka interesim s'ka problem...? Edhe pse nuk është e thjeshtë, por hiq nuk ka problem...

**Valdete Daka**: Në këtë komitet nuk duhet me pa a është i kësaj, apo asaj partie, këtu me rëndësi është që anëtari me qenë i fushës profesionale, dhe jo vetëm me qenë një komitet proformë... Këtu, nuk duhet me e pa çështjen opozitë – pozitë...

Pas një analize dhe shqyrtimi të gjatë, anëtarët e KQZ-së vendosën me vota unanime që Arianit Elshani të jetë anëtar i këtij komiteti.

## **9. Të ndryshme**